33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. PAGESA E VËRTETUAR nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punim dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-25-851-5-2-1/C1065

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e ofertës me vlefshmëri prej 150 dite nga data e nënshkrimit të kontratës, apo shprehur nominalisht 30.780.41€
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi,

		kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 10 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë max 10 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 120 ditë pune
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës. Data e përfundimit të punëve të parapara me këtë kontrate, nuk duhet të jetë më larg se 30.10.2025. Çdo tejkalimi, ose mosrespektim të KPK dhe KVK, konsiderohet shkelje e afateve kohore për përfundimin e punëve dhe do të ekzekutohen penalet
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxher Caktohet: 1. Besart Zejnullahu, Kryesues. 2. Armend Aliu, Anëtarë, Ndërsa MDMK caktohet, Rrahmon Olluri
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas leshuarjes së Certifikates së Përkohshme të Perdoritimit.
Parapagimi	26.1	Ska
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do të sjellë sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% të vlerës së kontratës për 1 vit apo 12 muaj i cili do të perdoret për përmirsim të defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM të punëve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR, sipas manualit-doracakut të KRPPsë, i publikuar më dt 08.07.2024
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 10 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës në formë të sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) në afat 1 vjeçar apo 12 muaj pas CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM

Pagesa shkëputjes së kontratës pas	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

PARAMASA
QKMF LIPJAN
LOKACIONI: LIPJAN
INVESTITORI: KOMUNA LIPJAN
VËREJTJE:
Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristikat të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Ne të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PERFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

A PUNËT NDERTIMORE					
15 PUNËT E PARTERIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
15.1	Germimi sipërfaqësor si dhe largimi i shtresës së humusit në thellësi 20cm për rregullimin oborrit. Logaria për m ² .	m ²	9,066.00	4.85 €	43,970.10 €
15.2	Germimi i gjere i dheut të kategorisë III-IV për rregullimin oborrit. Logaria për m ³ .	m ³	350.00	5.95 €	2,082.50 €
15.3	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së nënstrukturës së rrugës me material guror mbushës 0-150 mm. 30cm Ngjeshja me mjete mekanike deri në arritjen e modulit të ngjeshjes Mv = 50 MPa. Kontrolli i modulit të ngjeshjes sipas provës me pllake rrethore me diametër 30cm. Testimi të bëhet me lageshti optimale. Standardi i aplikueshem DIN 18134	m ³	997.00	12.00 €	11,964.00 €
15.4	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit me material të granular 0-60 mm. Në shtresa t=25 cm me saktësi deri në ± 3 cm. për trotuar dhe në pjesët për zgjerimin e rrugës. Ngjeshja me mjete mekanike deri në arritjen e modulit të ngjeshjes Mv = 60 MPa. Kontrolli i modulit të ngjeshjes sipas provës me pllake rrethore me diametër 30 cm. Testimi bëhet në materialet me lageshti optimale. Standardi i aplikueshem, DIN 18134	m ³	831.00	14.00 €	11,634.00 €
15.5	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit me material të granular 0-30 mm. Në shtresa t=10 cm me saktësi deri në ± 3 cm. për trotuar dhe në pjesët për zgjerimin e rrugës. Ngjeshja me mjete mekanike deri në arritjen e modulit të ngjeshjes Mv = 80 MPa Kontrolli i modulit të ngjeshjes sipas provës me pllake rrethore me diametër 30 cm. Testimi bëhet në materialet me lageshti optimale. Standardi i aplikueshem, DIN 18134	m ³	332.00	15.00 €	4,980.00 €
15.6	Furnizimi dhe vendosja e gurëve skajorë me dimensione b/h=18/24cm dhe klasë të betonit C30/37 të vendosur në shtresë betoni C20/25 (vendosja sipas detaleve të dhëna në projekt dhe në përputhje me standartet EN 1340).	m ¹	685.00	11.00 €	7,535.00 €
15.7	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit AB - 16 nga agregati - guri i njëtrajtshëm me trashësi t=7cm në gjendje të ngjeshur sipas standarteve EN 12697.	m ²	3,322.00	11.00 €	36,542.00 €
15.8	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit AB - 11 nga agregati - guri i njëtrajtshëm me trashësi t=4cm në gjendje të ngjeshur sipas standarteve EN 12697.	m ²	3,322.00	7.00 €	23,254.00 €
15.9	Furnizimi dhe montimi i kubezave të betonit dim:40/60/8.0cm ngjyra dhe dizajni sipas organit mbikqyrës.paraprakisht të bëhet shtruarja e rëres se imët t=5.0cm si dhe ngjeshja e tij	m ²	30.00	20.00 €	600.00 €
15.10	Furnizimi dhe montimi i granitit black galaxy sipërfaqe jo e rreshqitshme I vrazhde, t=3cm ngjyra dhe dizajni sipas organit mbikqyrës.paraprakisht të bëhet shtruarja e rëres se imët t=5.0cm si dhe ngjeshja e tij	m ²	18.00	140.00 €	2,520.00 €
15.11	Furnizimi dhe montimi i kubezave të betonit dim:20/20/8.0cm ngjyra dhe dizajni sipas organit mbikqyrës.paraprakisht të bëhet shtruarja e rëres se imët t=5.0cm si dhe ngjeshja e tij	m ²	1,086.00	18.00 €	19,548.00 €
15.12	Furnizimi dhe montimi i kubezave- kallderm me granit me dim:115/60/8 cm ngjyra dhe dizajni I zi sipas organit mbikqyrës.paraprakisht të bëhet shtruarja e rëres se imët t=5.0cm si dhe ngjeshja e tij	m ²	340.00	35.00 €	11,900.00 €
15.13	Furnizimi dhe montimi i kubezave- kallderm me granit me dim:115/60/8 cm ngjyra dhe dizajni I bardhe sipas organit mbikqyrës.paraprakisht të bëhet shtruarja e rëres se imët t=5.0cm si dhe ngjeshja e tij	m ²	606.00	35.00 €	21,210.00 €

15.14	Furnizimi dhe vendosja e ansoreve rreth kubezave te betonit me dim:20x8x100cm	m ^l	1,150.00	7.50 €	8,625.00 €
15.15	Furnizimi me material dhe rregullimi i pjesëve të parapara për gjelbrim duke përfshirë nivelizimin e dheut të ngjeshur, modelimin e terrenit, rikthimin e dheut të deponuar më parë, plehërimin, rrafshimin e sipërfaqes, mbjelljen me bar, deri në përgaditjen për mbjellje të luleve, shkurreve dekorative dhe drunjve të llojeve të ndryshme.	m ²	4,400	2.50 €	11,000.00 €

15.16	Sigurimi, transportimi dhe mbjellja e shkurreve te ndryshme me gjatesi 0.5- 1m te llojeve te ndryshme BUSHI, PISHA , ETJ Mirembajtja te jete 1- vitë. Llogaria per cope.	copë	220	15.00 €	3,300.00 €
15.17	Sigurimi, transportimi dhe mbjellja e fidaneve me gjatesi 1,70 - 1,80m te llojeve te ndryshme CATALPA , PRUNUS PISARDI , AESCULES HIPPOCASTANUM , ACER PLAT DRUMMONDI , ETJ Mirembajtja te jete 1- vitë. Llogaria per cope.	copë	20	60.00 €	1,200.00 €
15.19	Furnizimi dhe montimi I murit te betonit te uleseve te jashtme ne oborrin e QKMF-se, sipas projektit	copë	8	450.00 €	3,600.00 €
15.20	Furnizimi dhe montimi I uleseve te jashtme nga qellku-druri ne oborrin e QKMF-se, sipas projektit	copë	20	350.00 €	7,000.00 €
15.21	Furnizimi dhe montimi I kendit te lodrave per femije	copë	1	4,000.00 €	4,000.00 €
15.22	Punet e paparapara te ky pozicion ose nderrimi I ndonje pozicioni te cilin duhet pajtetur ti nderrohet destinimi si kerkese e stafit punues ne QKMF.Ky pozicion te llogaritet me perqindje 3% e shumes se pos 15.1-15.21	3%	0.03	236,464.60 €	7,093.94 €
15.23	Rrënimi komplet i objektit të maternitetit (parashihet edhe përdorimi i eskavatorit me çekiq pneumatik) dhe nxerrja e largimi i themeleve nga betoni dhe armatura si dhe transportimi i inerteve deri në deponi. -Nderprerja e instalimeve elektrike, ujit dhe rrjeteve tjera infrastrukturore e objektit qe do te rrenohet, Nderprerja ne menyre profesionale dhe te sigurt. -Bartja e inventarit që gjinden në objektet që do të rrenohen, inventari i mbetur duhet te largohen deri në deponi sipas udhezimeve të menaxherit. -Demolimi dhe largimi me kujdes i dritareve dhe dverve egzistuese duke pasur kujdes qe te mos demtohen keto asete. keto asete komunale kan dimenzione te ndryshme. keto asete te dergohen sipas urdhereses nga Drejtoria e Shendetesise komunale, ne deponin e autorizuar per te njejtat sherbime. Në cmim përfshihet të parashihen të gjitha këto pozicione të cekura me lart.(Objekti nr.3)	m ³	600	5.50 €	3,300.00 €
15.24	Rrënimi komplet i objektit të emergjences (parashihet edhe përdorimi i eskavatorit me çekiq pneumatik) dhe nxerrja e largimi i themeleve nga betoni dhe armatura si dhe transportimi i inerteve deri në deponi. -Nderprerja e instalimeve elektrike, ujit dhe rrjeteve tjera infrastrukturore e objektit qe do te rrenohet, Nderprerja ne menyre profesionale dhe te sigurt. -Bartja e inventarit që gjinden në objektet që do të rrenohen, inventari i mbetur duhet te largohen deri në deponi sipas udhezimeve të menaxherit. -Demolimi dhe largimi me kujdes i dritareve dhe dverve egzistuese duke pasur kujdes qe te mos demtohen keto asete. keto asete komunale kan dimenzione te ndryshme. keto asete te dergohen sipas urdhereses nga Drejtoria e Shendetesise komunale, ne deponin e autorizuar per te njejtat sherbime. Në cmim përfshihet të parashihen të gjitha këto pozicione të cekura me lart.(Objekti nr.1)	m ³	300	5.50 €	1,650.00 €
15.25	Rrënimi komplet i objektit të kryqit te kuq (parashihet edhe përdorimi i eskavatorit me çekiq pneumatik) dhe nxerrja e largimi i themeleve nga betoni dhe armatura si dhe transportimi i inerteve deri në deponi. -Nderprerja e instalimeve elektrike, ujit dhe rrjeteve tjera infrastrukturore e objektit qe do te rrenohet, Nderprerja ne menyre profesionale dhe te sigurt. -Bartja e inventarit që gjinden në objektet që do të rrenohen, inventari i mbetur duhet te largohen deri në deponi sipas udhezimeve të menaxherit. -Demolimi dhe largimi me kujdes i dritareve dhe dverve egzistuese duke pasur kujdes qe te mos demtohen keto asete. keto asete komunale kan dimenzione te ndryshme. keto asete te dergohen sipas urdhereses nga Drejtoria e Shendetesise komunale, ne deponin e autorizuar per te njejtat sherbime. Në cmim përfshihet të parashihen të gjitha këto pozicione të cekura me lart.(Objekti nr.4)	m ³	100	6.00 €	600.00 €
TOTAL POZICIONI					249,108.54 €

REKAPITULLIM		
1.15	PUNËT E PARTERIT	249,108.54 €
	PUNËT NDERTIMORE	GJITHSEJT 249,108.54 €
PARAMASA ME PARALLOGARI E INSTALIMIT ELEKTRIK		

Sqarim: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë, blerjen, transportin, montimin, lidhjet, përtokëzimin, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe lëshimin e atesteve. Në çmim duhet të kalkulohet edhe i tërë materiali i imët lidhës dhe montues. Para dhënjes së ofertës të lexohet pershkrimi teknik dhe të shiqohen vizatimet.

1.0 RRYMA E FORTE

1.1 Kuadrot kryesorë dhe shpërndarës dhe furnizimi i tyre

Poa.	Përshkrimi i punëve	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSË ME TVSH	TOTALI ME TVSH
20	Furnizimi dhe montimi i kabllos furnizuese te Gjeneratorit 200kVA, PP00-A (kablo alumini) 2*(4x 240mm ²)	m'	100	25.00 €	2,500.00 €
22	Material tjetër lidhës(kanale,lidhëse,bulona etj) 2% nga totali i kësaj pike	2%	0.02	2,500.00 €	50.00 €
TOTAL POZICIONI				1.1	2,550.00 €

2.0 RRYMA E DOBËT

2.5. INSTALIMI I SISTEMIT TE KONTROLLIT AUTOMATIK TË PARKINGJEVE

Nr.	Emertimi dhe llojet e punimeve	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSË ME TVSH	TOTALI ME TVSH
	Blerja, transporti, montimi, shtrirja e kablave, lidhja dhe programimi me afësim të personelit e sistemit të kontrollimit të vendeve për parkim të veturave . Ne				
1	Kolona e hyrjes-daljes në parking me pajisjen përkatëse me të gjitha pjesët përcjellëse lidhëse Name High-Speed Gate Barrier (Laurat) Size(mm) 300(Ë) x 300(D) x 1000(H) Eëight(kg) 40kg Poëer input AC 110 ~ 220V ±10% Distanca e telekomandes 30m RFID-Karteles Temperature -10 ~ +40°C Lageshtia 10 ~ 90% Operation speed Open speed 1.5 sec, Close speed 2 sec	copë	4	1,200.00 €	4,800.00 €
TOTAL POZICIONI				2.5	4,800.00 €

2.6. INSTALIMI I SISTEMIT TE KONTROLLIT TE QASJES SE PERSONELIT MJËKSORE

Nr.	Emertimi dhe llojet e punimeve	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSË ME TVSH	TOTALI ME TVSH
	Blerja, transporti, montimi, shtrirja e kablave, lidhja dhe programimi me afësim të personelit e sistemit të kontrollimit të qasjes së personelit mjeksore. Paguhet				
1	Kontrolleri i qasjes (Access Controller)	copë	1	100.00 €	100.00 €
2	RFID lexuesi (RFID card reader)	copë	30	10.00 €	300.00 €
3	Butoni për dalje (Exit button)	copë	2	45.00 €	90.00 €
4	Mbyllësi magnetik (Magnetic lock)	copë	1	35.00 €	35.00 €
5	Bllokues elektrik (Elektric drop lock)	copë	1	40.00 €	40.00 €
6	Burimi i ushqimit (poëer supply Control)	copë	1	55.00 €	55.00 €
TOTAL POZICIONI				2.6	620.00 €

REKAPITULLIM RRYMAT E DOBËT

5	2.5. INSTALIMI I SISTEMIT TE KONTROLLIT AUTOMATIK TË PARKINGJEVE	4,800.00 €
6	2.6. INSTALIMI I SISTEMIT TE KONTROLLIT TE QASJES SE PERSONELIT MJËKSORE	620.00 €
GJITHSEJT		5,420.00 €

3. DIZEL GJENERATORI

Pos.	Emertimi dhe llojet e punimeve	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSË ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3.10	Blerja, transporti, montimi dhe lidhja e dizel gjeneratorit siq është pershkruar në pershkrimin teknik. nje dizel gjeneratore me startim dhe kontrole automatike në punë paralele me kapacitet 200 kVA, 500 V, 50 Hz, komplet me panel	copë	1	20,000.00 €	20,000.00 €
TOTAL POZICIONI				3.1	20,000.00 €

REKAPITULLIM DIZEL GJENERATORI


1	3. DIZEL GJENERATORI	20,000.00 €
GJITHSEJT		20,000.00 €

4. NDRIQIMI I JASHTËM

Punët përgatitore

A	Poz	Përshkrimi dhe përmbajtja e pozicionit	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSË ME TVSH	TOTALI ME TVSH
	1	Gërmimi i dheut dhe përgatitja e kanalit me dimensione 80*40cm me makinë. Gjatësia e kanalit është 500m.(500*0.8*0.4)m.Në llogari të merret edhe transporti i dheut të tepërt deri në deponi të qytetit.	m ³	160	5.00 €	800.00 €

2	Blerja, transporti dhe vendosja e kablos NYY-J 4x35 mm ² (Cu) në Gyp ø70 nga KKK e QKMF-së deri te kuadri i ndriqimit publik K _n	m'	5	25.00 €	125.00 €
---	--	----	---	---------	----------

3	Blerja, transporti dhe vendosja e kablos PP00-A 4*16 mm ² (Cu) në Gyp Ø70 në trasenë e ndriqimit publik L1 dhe L2. Në këtë pikë përfshihet edhe gypi Ø70 përgjatë trasesë së ndriqimit të jashtëm.	m'	400	4.00 €	1,600.00 €	
4	Blerja, transporti dhe vendosja e kablos PP00-A 4*10 mm ² (Cu) në Gyp Ø50 në trasenë e ndriqimit publik L3. Në këtë pikë përfshihet edhe gypi Ø50 përgjatë trasesë së ndriqimit të jashtëm.	m'	100	3.00 €	300.00 €	
5	Blerja, transporti dhe vendosja e shiritit Fe/Zn 20*3mm në kanal in e trasesë së ndriqimit publik	m'	500	2.00 €	1,000.00 €	
6	Blerja, transporti dhe shtruarja e rërës mbi dhe nën në trashësi prej ±10cm.	m ²	20	30.00 €	600.00 €	
7	Përgatitja e bazamentit të shtyllave ndriçuese (8m) me dimenzione 600*600*800mm me beton të markës MB20	copë	35	50.00 €	1,750.00 €	
8	Blerja, transporti dhe vendosja e shiritit identifikues në kanal in e përgatitur më parë	m'	500	0.50 €	250.00 €	
9	Porosia, furnizimi dhe vendosja e ankerave Ø22mm , me gjatësi L=60cm, në betonin paraprakisht të përgatitur më parë. Këta ankerë parashihen për trupat ndriçues të gjatësisë 8m.	copë	35	10.00 €	350.00 €	
10	Porosia, furnizimi dhe vendosja e ankerave Ø16mm , me gjatësi L=60cm, në betonin paraprakisht të përgatitur më parë. Këta ankerë parashihen për trupat ndriçues të gjatësisë 4m.	copë	8	10.00 €	80.00 €	
11	Përgatitja e bazamentit të shtyllave ndriçuese (4m) me dimenzione 500*500*800mm me beton të markës MB20	copë	8	40.00 €	320.00 €	
12	Blerja, transporti dhe montimi i shtyllave ndriçuese. Shtylla duhet të jetë e zinkuar (e zhytur tërësisht në zink). Pjesa e parë e shtyllës nga bazamenti është me gjatësi 2m dhe diametër Ø159mm, pjesa e dytë me gjatësi 2m dhe diametër Ø133mm, pjesa e tretë me gjatësi 2m dhe diametër Ø108mm dhe pjesa e katërt me gjatësi 1m dhe diametër Ø76,1mm. Trashësia e mureve të shtyllës është 4mm. Lartësia e shtyllës ndriçuese është 8m. Në këtë pikë të parashihen edhe bazat e aralditit për lidhjen e përcuseve në kuadrin e trupit ndriçues.	copë	35	210.00 €	7,350.00 €	
13	Porosia, furnizimi dhe vendosja e kablos PP 3*2.5 mm ² nga pika e lidhjes së llampës ndriçuese në shtyllë deri te bornat lidhëse të shtyllës ndriçuese	m'	400	0.80 €	320.00 €	
14	Blerja, transporti dhe montimi i mbajtësit të trupit ndriçues (LIRA) për vendosje në shtyllën e gjatësisë 8m me dimenzione 1000mm-10', Ø60 dhe me trashësi të murit të gypit 4mm. Mbajtësi duhet të jetë i pajisur me unazën për shtrëngim në shtyllë.	copë	35	45.00 €	1,575.00 €	
15	Blerja, transporti dhe montimi i llampave ndriçuese efikente të energjisë elektrike tip :LED Q-830 120-277V/. Luminous flux (Luminaire): 14226 lm /Luminous flux (Lamps): 4099 lm / Luminaire Éattage: 147.0 É .Light Color 3000K. Llambat ndriçuese mund të jenë edhe prodhime tjera nga LED-i , por jo të fuqisë më të vogël.	copë	35	155.00 €	5,425.00 €	
16	Blerja, transporti dhe montimi i trupit ndriçues dekorativ komplet me llampën ndriçuese e tipit Siteco DL20, 3010lm, 4000K, IP65, 28É, 100000h pune. Lartësia e trupit ndriçues është 4m		copë	8	230.00 €	1,840.00 €
17	Blerja, transporti dhe montimi i trupit ndriçues dekorativ komplet me llampën ndriçuese e tipit Gray body bollard , 4000K, IP65, 28É, 100000h pune. Lartësia e trupit ndriçues është 0.5m		copë	8	50.00 €	400.00 €
				TOTAL POZICIONI	A	24,085.00 €

B Punët finale të ndriqimit të jashtëm					
SGARIM - Në këtë pikë përfshihet blerja, transporti dhe montimi i pajisjeve përkatëse të përshkuara sipas pozicioneve të mëposhtme					
Poz.	Përshkrimi dhe përmbajtja e pozicionit	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	Bazamente siguresash trepolëshe komplet Tip:ETI 100A ose të ndonjë prodhuesi tjetër	copë	1	45.00 €	45.00 €
2	Kuti metalike me zbarë bakri për barazim potenciali për përcuesit N dhe PE	copë	1	15.00 €	15.00 €
3	Kuadër metalik me dimenzione 600x800x200	copë	1	100.00 €	100.00 €
4	TMRR 100/5A	copë	3	35.00 €	105.00 €
5	Shkarkues mbtensionit tip TTV2-60-4P(4*4)/500V, 15kA	komplet	1	150.00 €	150.00 €
6	Ndërprerës trepolar MCCB 3P/63A	copë	1	80.00 €	80.00 €
7	Siguresa gjysmëautomatike MCB B-10A, 1P	copë	1	4.00 €	4.00 €
8	Siguresa gjysmëautomatike MCB B-16A, 1P	copë	1	4.00 €	4.00 €
9	Siguresa gjysmëautomatike MCB B-20A, 1P	copë	1	4.00 €	4.00 €
10	Fotoqelula, 10A 220V	copë	1	20.00 €	20.00 €

11	Luxmetri	copë	1	40.00 €	40.00 €
12	Llampë ndriçuese me poqë neoni 8Ë për montim brenda kuadrit shpërndarës e cila duhet të jetë e pajisur me ndërprerës manual 0-1.	copë	1	15.00 €	15.00 €
13	Kontaktor tip TR1D/F,25A/AC-3,220/380V	copë	3	35.00 €	105.00 €
14	Ndërprerës i rrymës diferenciale RCBO 40/30mA	copë	3	35.00 €	105.00 €
15	Prizë njëfazore OG	copë	1	5.00 €	5.00 €
16	Prizë trefazore OG	copë	1	10.00 €	10.00 €
17	Matja e tokzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokzimit	copë	1	300.00 €	300.00 €
18	Material i imët i pa paraparë në paramasë(përçues, kleme, kanalina etj)	copë	1	100.00 €	100.00 €
TOTAL POZICIONI				B	1,207.00 €

REKAPITULLIM NDRICIMI I JASHEM				
A	Punët përgatitore			24,085.00 €
B	Punët finale të ndriqimit të jashtëm			1,207.00 €
GJITHSEJT				25,292.00 €

5	Të bëhet dorzimi i vizatimeve të gjendjes ekzistuese sipas ekzekutimit të punëve elektrike dhe skemave njëpolare AS BUILD	komplet	1	500.00 €	500.00 €
---	---	---------	---	----------	----------

REKAPITULLIM					
1	1.0 RRYMA E FORTE				2,550.00 €
2	2.0 RRYMA E DOBËT				5,420.00 €
3	3. DIZEL GJENERATORI				20,000.00 €
4	4. NDRIQIMI I JASHEM				25,292.00 €
